



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 810, datë 13.12.2019

P Ë R

**PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES
SË FATKEQËSISË NATYRORE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri në datën 31.3.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA

MINISTRI I MBROJTJES

OLTA XHAÇKA

NR.PROT. 6161
DATË 14.12. 2019

KUVENDIT
MINISTRISË SË MBROJTJES
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI



Ishqiptaria

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është zgjatja deri në datën 31 mars 2020 e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, shpallur me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar. Gjendja e fatkeqësisë natyrore, e cila shoqërohet me marrjen e masave të jashtëzakonshme në këto qarqe, sipas vendimit të shpalljes përfundon përkatësisht në datat 28 dhe 30 dhjetor 2019.

Objektivat e këtij projektvendimi janë garantimi i sigurisë së jetës së banorëve, sigurimi i veprimtarisë normale për jetesën e komuniteteve të prekura në këto zona, si dhe marrja e masave parandaluese, mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

II. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të neneve 100 e 174, të Kushtetutës, dhe të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”.

Gjendja e fatkeqësisë natyrore, e pjesshme apo në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, është një nga 3 masat e jashtëzakonshme të parashikuara nga Kushtetuta, së bashku me gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme.

Mënyra e vendosjes së kësaj mase, procedurat, të drejtat dhe detyrimet parashikohen nga Kushtetuta, si dhe nga ligji mbi mbrojtjen civile, miratuar në vitin 2019, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), miratuar nga Këshilli i Ministrave në 2004, në mbështetje të ligjit për emergjencat civile të vitit 2001, tashmë të shfuqizuar me ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”.

Kushtetuta nxjerr në pah ndryshimet ndërmjet tri llojeve të masave të jashtëzakonshme edhe për faktin se gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme vendosen me ligj nga Kuvendi, pasi edhe kufizimi i të drejtave dhe lirive të individëve është i një game më të gjerë.

Në rastin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shpallja e gjendjes kryhet me vendim të Këshillit të Ministrave, për një afat 30-ditor dhe zgjatja e saj kryhet po nga Këshilli i Ministrave, me pëlqimin e Kuvendit.

Parashikimet ligjore kushtetuese (neni 174) kërkojnë që zgjatja e afatit 30-ditor të kryhet nga Këshilli i Ministrave, duke marrë "Pëlqimin" e Kuvendit ndërkohë që në bazë të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës, informon Kuvendin për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon miratimin e tij për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.

Pavarësisht përdorimit të dy termave që çojnë në dy procedura të ndryshme të Kuvendit, për përgjigjen ndaj kërkesës së Këshillit të Ministrave për zgjatjen e afatit tej 30 ditëve të gjendjes së fatkeqësisë natyrore (në çdo rast prevalon procedura e marrjes së pëlqimit dhe jo ajo e miratimit, pasi parashikohet në Kushtetutë), në vijim të këtij relacioni jepen argumentet bazë që justifikojnë kërkesën për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë deri më 31.3.2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishme të dekadave të fundit, ora 03:54:11, me magnitudë $M_g=6.3$ shkalla Rihter, në thellësi 38 km dhe me epiqendër 15 km në veri të qytetit të Durrësit.

Nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe deri në datën 9.12.2019 janë regjistruar në total, gjithsej, 1 775 tërmete, nga të cilat janë lokalizuar 422.

Qarqet më të dëmtuara nga tërmeti janë Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Qarqet e tjera ku ka dëmtime: Dibër, Kukës, Fier, Elbasan, Berat.

Gjithsej janë 51 persona që kanë humbur jetën nga tërmeti.

Në Durrës: 25 viktima.

Në Thumanë: 24 viktima.

Në Lezhë: 1 viktimë.

Në Tiranë: 1 viktimë.

Qarku Durrës: 47 persona të nxjerrë nga rrënojat.

Dëmet në banesa

Nga informacionet e deritanishme rezulton:

Për qarqet Durrës, Tiranë, Lezhë:

Banesa të dëmtuara rëndë Tiranë, Durrës: 2002.

Banesa të dëmtuara lehtë Tiranë, Durrës: 4380.

Pallate të dëmtuara rëndë Tiranë, Durrës: 135.

Pallate të dëmtuara lehtë Tiranë, Durrës: 543.

Pallate të pabanueshme Tiranë, Durrës: 60.

Qarku Lezhë:

Pallate të dëmtuara rëndë: 66.

Pallate me dëmtime të mesme: 45.

Pallate me dëmtime të lehta: 263.

Apartamente të dëmtuara rëndë: 1353.

Apartamente me dëmtime të mesme: 559.

Apartamente me dëmtime të lehta: 1 297.

Vila të dëmtuara rëndë: 235.

Vila me dëmtime të mesme: 181.

Vila me dëmtime të lehta: 57.

Shkolla të dëmtuara: 37 (Tirana 32, Lezha 5).

Kabina elektrike të dëmtuara: 15 (Tiranë).

Biznese të dëmtuara: 106 (Tiranë).

Qendra shëndetësore: 1 (Tiranë 1).

Persona të evakuuar, strehuar në hotele, çadra, qendra sociale dhe familje:

Të evakuuar: 3224.

Hotele: 1 961 persona.

Çadra: 964.

Qendra sociale: 867.

Familje: 2 525.

Ende vazhdon puna për vlerësimin e dëmeve dhe për shpërndarjen e ndihmave të ardhura nga shtete e organizata ndërkombëtare dhe donatorë të brendshëm.

Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të

Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” dhe me vendimin nr.751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave është përfshirë dhe Qarku Lezhë.

Vendimi nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, ai i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kishte si pikë të veçantë ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili përgatiti një program pune të detajuar për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti.

Ndërkohë është aktivizuar dhe Mekanizmi i Mbrojtjes Civile Evropiane.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, shumë shtete dërguan menjëherë ekipet e tyre si dhe ndihmë humanitare. Njëpërmjet EADRCC-së, i është kërkuar ndihmë dhe shteteve anëtare të NATO-s.

Për sa i përket kohëzgjatjes maksimale të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, neni 174, i Kushtetutës, parashikon një periudhë maksimale 30-ditore, në bazë të së cilës është shpallur gjendja e fatkeqësisë, që në rastin konkret është krijuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Ligji i mbrojtjes civile parashikon se gjendja e fatkeqësisë natyrore kalon në disa faza, të cilat fillojnë me ndodhjen e fatkeqësisë natyrore, vijon me fazat e kërkim-shpëtimit, verifikimit e pasojave dhe fazën finale të rregullimit të pasojave njëpërmjet rindërtimit.

Duke pasur parasysh se gjatë 30 ditëve të para pas tërmetit të datës 26.11.2019 përfundoi faza e kërkim-shpëtimit dhe filloi faza e verifikimit, përfundimi i fazës së verifikimit, hartimi dhe zbatimi i masave afatshkurtra të rregullimit të pasojave me qëllim sigurimin e jetës dhe të shëndetit të individëve është baza e nevojës për zgjatje të afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë, Lezhë.

Duke pasur, gjithashtu, parasysh se lëkundjet e tërmetit ndonëse me frekuencë dhe intensitet më të ulët vazhdojnë të ndihen në qarqet e përmendura, veprimtaria e strukturave operacionale dhe nevoja e marrjes së masave në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore është emergjente, si në ditët e para të marrjes së masës. Konkretisht, vetëm gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore:

- strukturat operacionale dhe drejtuesit e tyre (Ushtria, policia, zjarrfikësit, emergjenca mjekësore) janë në dispozicion të KNEC-së;
- mund të vendosen dhe të zbatohen masa të jashtëzakonshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë, si ndaj

institucioneve publike, qendrore dhe vendore, ashtu edhe ndaj privatëve përfshirë edhe gjopa në rast të moszbatimit të këtyre masave;

- kryhet zyrtarisht apeli për asistencë, drejtuar organizmave ndërkombëtarë dhe shteteve të tjera, kërkesat e specifikuara për nevojat për asistencë dhe raportet periodike të situatës për Qendrën Evropiane të Koordinimit të Emergjencave, për Qendrën Euroatlantike të Koordinimit të Përgjigjes për Fatkeqësitë;
- mediat dhe organet e tjera të informimit publik janë të detyruara t'u referohen burimeve zyrtare për njoftime lidhur me numrin e viktimave, listën e emrave dhe të parashikimeve të mëtejshme për mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të tjera, duke shmangur transmetimin e informacioneve sensitive, si dhe duke mos krijuar panik te publiku, në asnjë rast;
- autoritetet mund të vendosin gjopa nga 100 000 (njëqind mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë ndaj bashkive, subjekteve private dhe shtetasve nëse nuk përmbushin detyrimet.

KËSHILLI I MINISTRAVE